



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Raport përmbledhës: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Gusht 2024

Prishtinë, Shtator 2024

PËRMBLEDHJE E STATISTIKAVE TË INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT (IHÇK), GUSHT 2024

Në këtë raport janë përmbledhur dhe analizuar statistikave për **Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), deri Gusht 2024**.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) bën publikime të rregullta mujore dhe vjetor të Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) duke ofruar të dhëna serike statistikore të ndryshimeve të çmimeve të konsumit prej muajit maj, nga viti në vite. (viti bazë 2015=100).

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është tregues relativ që paraqet dinamikën e ndryshimeve apo lëvizjen e çmimeve me pakicë për artikujt e shërbimet më reprezentues të konsumuar nga ekonomitë familjare në periudhë të caktuar kohore të përfshirë në grupe dhe nëngrupe të klasifikuara sipas nomenklaturës ndërkombëtare të ashtuquajtur COICOP (Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit).¹

IÇK përkatësisht IHÇK si parametër statistikor, ndryshe njihet edhe si Indeksi i Kostos së Jetesës, gjithashtu merret edhe si parametër për matjen e **Inflacionit**. Ky parametër statistikor ka një rëndësi të veçantë për rrjedhat ekonomike financiare të vendit, zhvillimin e politikave financiare, matjen e standardit të jetesës, harmonizimin e të ardhurave personale, qarkullimin tregtar e tjerë.

¹ Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit (COICOP) është pjesë të një grupi klasifikimesh të shpenzimeve sipas qëllimit, të njohura edhe si klasifikime "funktionale", të cilat janë pjesë e Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA) që nga viti 1968. "Informacioni i kërkuar në lidhje me shpenzimet është domosdoshmërisht më i detajuar se ai për të ardhurat. Zërat e ndryshëm mbi të cilët familjet shpenzojnë të ardhurat e tyre mund të kombinohen në një numër të vogël grupesh mjaft të përcaktuara qartë - për shembull, ushqimi, strehimi, veshmbathja, karburanti dhe drita - dhe gjithashtu zëra të ndryshëm shpenzimesh të cilat mund të kombinohen së bashku ose në një grup i përgjithshëm ose në disa klasa ose nëngrupe të veçanta."

Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën e mëposhtme, evidentohen disa ndryshime te vogal në indekset e çmimeve gjatë periudhes janar gusht 2024. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,4 % në muajin Gusht 2024 krahasuar me muajin Gusht 2023. Kjo tregon një rritje të lehtë të çmimet me tendenc ngadalësim krahasuar me periudhën e kaluar trevjeçare.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (26,3%), kafja, çaji dhe kakao (8,9%), pushime të organizuara (7,5%), peshqit (6,3%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj.(6,2%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (5,6%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (4,9%), veshje (4,5%), pijet alkoolike (4,3%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (3,7%), shërbimet financiare (3,7%), kujdesi personal (3,6%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (3,2%), buka dhe drithërat (3,2%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (3,0%), duhani (2,8%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (2,4%), pemët (2,3%), prodhimet ushqimore (2,1%), mishi (2,0%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (1,2%), shërbimet hoteliere (1,0%), qumështi, djathi dhe vezët (0,7%) dhe energjia elektrike (0,7%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,2 për qind në IHÇK.


Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: perimet (-7,6%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-5,3%) dhe blerja e automjeteve (-3,2%), me një ndikim prej -0,8 për qind në IHÇK.

Inflacioni mujor ishte 0,2% në gusht 2024, rrjedhimisht Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,2% në muajin Gusht 2024 krahasuar me muajin Korrik 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (12,2%), perimet (2,1%), qumështi, djathi dhe vezët (0,7%), mishi (0,5%) dhe buka dhe drithërat (0,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,4 për qind në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-2,3%) me një ndikim prej -0,2 për qind në IHÇK.

Në vazhdim paragjajta grafike e Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK.


Figure 1. Norma mujore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në figurën 1, janë paraqitur ndryshimet e çmimeve të konsumit në baza mujore gjatë periudhës Janar 2022 deri Gusht 2024.

Figure 2. Norma vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në figurën 2, janë paraqitur ndryshimet e çmimeve të konsumit në baza vjetore 2020 deri 2023 dhe një parallogaritje për periudhës Janar deri Gusht 2024, bazuar në të dhënat e disponushme nga Agjencia e Statistikave.

Figuar 4. Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP Grupe dhe nëngrupet	Pesha 2024 në ‰	VIII-2024 2015=100	VIII-2024 VII-2024	VIII-2024 VIII-2023
00. IHÇK total	1,000.0	130.2	0.2%	1.4%
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	351.1	144.2	0.4%	1.7%
02. Pije alkoolike, duhan	67.6	140.9	0.1%	3.3%
03. Veshje dhe këpucë	40.6	109.1	0.1%	3.4%
04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	89.8	122.0	-0.2%	2.7%
05. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinë të shtëpisë	63.0	122.8	0.3%	2.2%
06. Shëndeti	22.8	116.3	0.0%	0.8%
07. Transporti	176.7	123.3	0.2%	-1.3%
08. Komunikimi	23.7	114.4	0.0%	-0.2%
09. Rekreacion dhe kulturë	44.5	107.5	0.4%	2.3%
10. Arsimi	6.9	104.2	0.0%	-0.7%
11. Restorante dhe hotele	40.8	130.3	0.1%	1.0%
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	72.2	119.7	0.1%	1.9%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Në figurën 3, janë paraqitur peshat për grupe dhe nëngrupet dhe ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it.

Nga tabela mund të shihet se lëvizjet e çmimeve të grupi dhe nëngrupi i artikujve të 01.Ushqime dhe pije joalkoolike, pasuar nga lëvizja e çmimeve të grupe dhe nëngrupet 07.Transporti dhe 04. Banesa, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera, kanë ndikimin përcaktues (me pesha 618 ‰) në ndryshimet mujore dhe vjetore.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin gusht 2024, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation>



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org